



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr.18/4Prot.

Tiranë, më 02.05.2018

### V E N D I M

**Nr.40, datë 02.05.2018**

### **MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT TË MARRË NËPËRMJET KËRKESËS SË PUNONJËSES \*\*\*\*\* , PROTOKOLLUAR ME NR. 18 PROT., DATË 12.01.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

### **VËREJ SE :**

Me anën e kërkesës/informacionit të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 18 prot., datë 12.01.2018, nëpunësja \*\*\*\*\* , me detyrë “Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Njësinë Administrative Nr. 2, të Bashkisë Tiranë, ka ngritur pretendimin se, procedura e ndjekur ndaj saj për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”.

Me shkresën nr. 58 prot., datë 05.01.2018, me lëndë “Vërejtje”, Administratori i Njësisë Administrative Nr. 2, duke përdorur si bazë ligjore nenin 58, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” dhe për këtë ka njoftuar nëpunësen në fjalë, si dhe ka informuar Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Tiranë.

Në përmbajtje të kësaj shkrese rezulton se, masa disiplinore ndaj nëpunëses është dhënë pasi gjatë kontrollit të ushtruar në datën 04.01.2018, ora 08.45, për zbatimin e orarit dhe procedurave të hyrje daljeve në institucion, ka lejuar të nënshkruajë në regjistrin e hyrje daljeve, Specialistin e Urbanistikës, i cili u paraqit me vonesë në punë (në orën 08.45), në një kohë kur orari zyrtar i punës në administratën e bashkisë, është 08.00-16.00. Në lidhje me këtë aspekt, është mbajtur edhe një procesverbal, ku materializohet ky fakt.

Rasti i mësipërm është vlerësuar nga administratori, si thyerje disiplinore, duke arsyetuar se nëpunësja \*\*\*\*\*, e ngarkuar për kontrollin e zbatimit dhe shfrytëzimit të kohës së punës, nuk e ka kryer si duhet detyrën, pasi në kundërshtim me urdhrin e drejtuesit të njësisë, ka lejuar një punonjës të fillojë punën, megjithëse kishte ardhur me vonesë.

Në rastin në fjalë, nga ana e administratorit, (duke marrë atributet e organit disiplinor), shkelja e mësipërme është klasifikuar si shkelje e lehtë e disiplinës në punë dhe ashtu si është e parashikuar në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka filluar procedura disiplinore, e cila është në kompetencë të eprorit direkt, bazuar mbi fakte konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil.

Ndërkohë, nisur nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit paraprak të rastit dhe në kuptim të dispozitave ligjore, vlerësohet se procedura për marrjen e masës disiplinore, është e parregullt, pasi nuk është kryer sipas kërkesave të parashikuara në nenin 58 e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 115, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”.

Në pikën 7, të nenit 59, të ligjit në fjalë, parashikohet shprehimisht se, “Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar”.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar për këtë rast, rezultoi se punonjësja \*\*\*\*\* nuk është njoftuar më parë për shkeljen e konstatuar, ashtu si e kërkon ligji, me qëllim që ajo të ishte e informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj.

Po kështu, punonjësja në fjalë nuk është dëgjuar dhe as nuk ka pasur mundësinë për të paraqitur prova, sepse nuk ka qenë e pranishme gjatë diskutimit për dhënien e masës ndaj saj, ashtu si e kërkon pika 13, e vendimit nr. 115, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”, ku parashikohet shprehimisht se:

*Në rastin e marrjes dijeni për një shkelje disiplinore, organi disiplinor fillon ecurinë disiplinore dhe njofton, me shkrim, nëpunësin përkatës:*

*a) për shkeljen disiplinore të pretenduar për të;*

- b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
- c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t'u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;
- ç) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi.

Në këto rrethana, si dhe në vijim të qëndrimeve të mbajtura nga Komisioneri për raste me të njëjtin objekt ankese, konstatohet se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, vazhdon të bëjë interpretim dhe zbatim të gabuar të legjislacionit të posaçëm për shërbimin civil, në lidhje me përcaktimin e eprorit direkt, duke ia atribuuar këto kompetenca drejtuesit të njësisë administrative (*administratori*), për nëpunësit civilë që ushtrojnë detyrën e tyre në këto struktura, me pretendimin se kjo e drejtë është dhënë nëpërmjet urdhrit nr. 17716/3, datë 25.07.2016, të Kyetarit të Bashkisë “Për delegim kompetence administratorëve të Njësive Administrative të Bashkisë Tiranë”.

Në lidhje me këtë problem (për pozicionin dhe rolin e administratorit në shërbimin civil), Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është shprehur edhe më parë, në rastet si më poshtë:

- Fillimisht me vendimin nr. 59, datë 20.05.2016, “Mbi vlerësimin e ligjshmërisë të procedimit disiplinor për disa prej punonjësve të Bashkisë Tiranë, (Njësia Administrative Farkë)”, në përmbajtje të të cilit arsyetohet mungesa e kompetencës së eprorit direkt, për nisjen dhe zhvillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësit civilë, të cilët ushtrojnë detyrën pranë njësive administrative të njësive të qeverisjes vendore.

- Më pas me shkresën nr. 64, datë 03.02.2017 “Kthim përgjigje kërkesës Tuaj, protokolluar pranë KMSHC me nr. 636/8, datë 26.01.2017”, në të cilën citohet “nisur nga përkufizimi që i ka bërë ligji “eprorit direkt” në pikën “e”, të nenit 4 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Administratori në asnjë rast **nuk mund të paraqitet si epror direkt** përpara një nëpunësi civil, por nuk ka asnjë pengesë që ai të vërë në lëvizje procesin dhe të shprehë kërkimet, apo opinionin e tij, me shkrim ose me gojë, përpara eprorit direkt, ose Komisionit të Disiplinës.

Duke u nisur nga mënyra si është e ndërtuar struktura organizative e Njësive administrative të Bashkisë Tiranë, eprori direkt do të gjendet në linjën vertikale të pozicioneve të punës, sipas natyrës dhe llojit të punës që kryen kjo linjë, në të cilën Drejtori i Përgjithshëm në Bashkinë e Tiranës, është nëpunësi më i lartë civil i saj.”

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se procedura e ecurisë disiplinore e zhvilluar ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*, vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 58, germa "a", nenit 59, pika 1 dhe pika 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe të Kreut I, pika 13, të vendimit nr. 115, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”.

Vendimi për masën disiplinore në këtë rast është marrë nga Administratori, i cili, siç u analizua më sipër, nuk mund të paraqitet në cilësinë e eprorit direkt përpara një nëpunësi civil.

Sjellja e Administratorit si epror direkt në rastin në fjalë, në kuptim të nenit 108, pika “a”, të germës “i” dhe “iii”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, bën që vendimi nr. 58, datë 05.01.2018, i Administratorit të Njesisë Administrative nr. 2, të Bashkisë Tiranë, për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunëses \*\*\*\*\*, të jetë një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore dhe për mos respektim të procedurës që duhet të zbatohet.

### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” e nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Për rregullimin e paligjshmërisë së këtij veprimi administrativ, Kryetari i Bashkisë Tiranë, duhet të konstatojë si një akt absolutisht të pavlefshëm, vendimin nr. 58, datë 05.01.2018, të Administratorit të Njesisë Administrative nr. 2, të Bashkisë Tiranë, për marrjen e masës disiplinore “Masë disiplinore vërejtje”, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*.
2. Njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Tiranë, në cilësinë e njesisë përgjegjëse, duhet të fshijë masën disiplinore nga dosja personale e nëpunëses \*\*\*\*\* dhe nga regjistri përkatës.
3. Për të rregulluar situatën në lidhje me funksionin e eprorit direkt, të nëpunësve civilë që ushtrojnë detyrën në njësitet administrative, njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Tiranë, në cilësinë e njesisë përgjegjëse, në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në bazë të rekomandimeve të Komisionerit, duhet të marrë masa për të përcaktuar skemën e funksionimit të shërbimit civil në njësitet administrative që janë pjesë e strukturës së bashkisë.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Tiranë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke paraqitur të gjitha aktet administrative që vërtetojnë masat e marra.
6. Të njoftohen për këtë vendim Bashkia Tiranë, njësia përgjegjëse e këtij institucioni dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të

ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**